

---

## PROCEDURA

### NË MBËSHTETJE TË VENDIMIT TË KKT-SË NR.1 DATË 30.07.2015 “PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE PROÇEDURAVE QË DO TË NDIQEN NGA AUTORITETET E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE PËR LEJE NDËRTIMI DERI NË MIRATIMIN E PLANEVE TË PËRGJITHSHME VENDORE”

---

Këshilli Kombëtar i Territorit më datë 30.07.2015 mori Vendimin Nr.1, “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave që do të ndiqen nga Autoritetet e Zhvillimit <sup>1</sup>të territorit për shqyrtimin e kërkesave për leje ndërtimi deri në miratimin e planeve të përgjithshme vendore”, ku ndër të tjera vendosi:

1. **Gjatë periudhës së hartimit të planeve të përgjithshme vendore, autoritetet e zhvillimit të territorit lejohen të japin leje ndërtimi vetëm për këto raste përjashtimore:**
  - a) *Punime të infrastrukturës* - çdo zhvillim i ri, me investim publik ose privat, për ngritje rrjetesh shërbimi ose sigurie publike, të rrjetit elektrik, rrjeteve të ujësjellësit, të kanalizimit, të ngrohjes, të telefonisë, internetit, të kanaleve të kullimit apo kanaleve të ujitjes, leje të sinjalistikës rrugore etj, nga operatorë publik/privat që ofrojnë apo synojnë ofrimin e shërbimeve publike/private sipas legjislacionit në fuqi.
  - b) *Struktura publike* – struktura, sipas përkufizimit të Ligjit të Planifikimit të Territorit, të financuara nga fonde publike.
  - c) *Ndërrhyrje me karakter emergjent* - objektet që paraqesin rrezik shembje me pasoja për jetën, shëndetin e njerëzve, pasurinë e të tretëve apo që paraqesin dëmtrim serioz të konstruksionit dhe funksionit të strukturës/ave ekzistuese, objekte që kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme, të vërtetuara nga raportet teknike të ekspertëve dhe rastet pasojë e forcave madhore apo rasteve të njësuara me to.
  - ç) *Objekte për interes publik, shtetëror dhe kombëtar* – objekte që janë të nevojshme për realizimin e objektivave / interesave të vendit (arsim, shëndetësi, kulturë, ekonomi, ushtri etj.) apo për kryerjen e investimeve strategjike, me mbështetje private ose publike.
  - d) *Struktura me funksion prodhues, industrial, përfshirë këtu ato me material porosities* – çdo zhvillim i ri, me investim publik ose privat, nga subjekte publike/private që ofrojnë apo synojnë rritjen e prodhimit industrial në vend, sipas legjislacionit në fuqi.
  - dh) *Struktura me funksion turistik* – sipas rregullave, kritereve dhe përcaktimeve të legjislacionit sektorial në fuqi në fushën e turizmit;

---

<sup>1</sup> Autoritet zhvillimi në këtë rast janë njësitë e qeverisjes vendore/ bashkitë (61 bashki sipas ndarjes së re territorial-administrative)

- e) *struktura në funksion të prodhimit, përpunimit dhe distribucionit të produkteve bujqësore dhe blegtorale*, – referuar strukturave të përcaktuara në VKM. Nr.283, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e tipeve, rregullave, kritereve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale në tokë bujqësore”, i ndryshuar;
- ë) *banesa individuale/njëfamiljare, kërkuar nga pronari i truallit për strehimin primar të tij me sipërfaqje totale ndërtimi deri në 250m<sup>2</sup>* – në këtë rast sipërfaqje totale ndërtimi nënkupton sipërfaqjen totale mbi tokë të objektit, referuar përcaktimeve të VKM Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, e ndryshuar;
- f) *shtesa në banesa individuale/njëfamiljare ekzistuese, deri në masën 50% të sipërfaqjes së tyre totale të ndërtimi* – në këtë rast sipërfaqje totale ndërtimi nënkupton sipërfaqjen totale mbi tokë të objektit, referuar përcaktimeve të VKM Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, e ndryshuar;

## **PROÇEDURA PËR ZBATIMIN E KËTIJ VENDIMI:**

### **HAPI I:**

Shqyrtimi i Kërkesës për pajisje me Leje Ndërtimi nga Autoritetet e Zhvillimit

- Autoriteti i Zhvillimit boton në Regjistrin e Integruar të Territorit (në vijim RIT), kërkesën për leje ndërtimi, në momentin e parë të aplikimit pranë sportelit të njësisë, apo në sportelin me një ndalesë (online, kur të realizohet). Kjo kërkesë botohet në RIT sipas pikës 4 të të Vendimit të KKT-së nr.1, datë 30.07.2015.
- Autoriteti i Zhvillimit, përpara miratimit/ refuzimit të kërkesës për leje ndërtimit, shqyrton kërkesën për kryerje punimesh (sipas shtojcës A të VKM. Nr. 408, datë 13.05.2015), e cila duhet të jetë në përputhje me rastet përjashtimore të pikës 2 të Vendimit të KKT-së nr.1, datë 30.07.2015.
- Autoriteti i Zhvillimit ndjek procedurat dhe hapat e nevojshme për miratimin/ refuzimin e kërkesës për leje ndërtimi dhe pajisjen/ ose jo të aplikuesit me leje ndërtimi.
- Autoriteti i Zhvillimit kryen kontrollin e kërkesës për leje ndërtimi duke u bazuar në legjislacionin përkatës për:
  - a) *Dokumentacionit për pajisje me Leje Ndërtimi, referuar nenit 15 të VKM Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar;*
  - b) *Planet e Përgjithshme Vendore të Miratuara para hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 115/2014, datë 31.7.2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të*

*qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë...*

- c) Zonat e Urbanizuara, sipas Vendimit Nr.5, datë 29.12.2014 të KKT;*
- ç) Çështjet, zonat, objektet e rëndësisë kombëtare, për të cilat është përgjegjës Këshilli Kombëtar i Territorit, referuar nenit 28 të Ligjit 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar;*
- d) Brigjet, (dete, liqene, lumenj, përrenj), sipas përcaktimeve të ligjit 111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”;*
- dh) Brezat e rezervimit të rrugës, sipas kategorive të përcaktuara në Rregulloren e Kodit Rrugor;*
- e) Brezat e rezervimit (hekurudhë, kanale, etj) sipas përcaktimeve të Rregulloreve sektoriale;*
- ë) Qendrat historike, zonat e mbrojtura, zonat e trashëgimisë kulturore, sipas përcaktimeve të legjislacionit sektorial në fuqi.*

#### **HAPII:**

Njoftimi i Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit për kërkesën për pajisje me Leje Ndërtimi nga Autoriteti i Zhvillimit nëpërmjet RIT

- Autoriteti i Zhvillimit njofton AKPT-në për përfundimet e arritura pas shqyrtimit të dosjes së aplikimit për pajisjen me Leje e Ndërtimi, duke botuar në RIT veç kërkesës për kryerje punimesh edhe raportin teknik të hartuar prej saj.

#### **Hapi III:**

Kontroli i Konformitetit nga Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit

Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit kryen kontrollin e konformitetit të kërkesës për pajisjen me Leje Ndërtimi me rastet përjashtimore sipas pikës 2 të Vendimit të KKT-së nr.1, datë 30.07.2015 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave që do të ndiqen nga autoritetet e zhvillimit të territorit për shqyrtimin e kërkesave për leje ndërtimi deri në miratimin e planeve të përgjithshme vendore”.

#### **Hapi IV:**

Informimi i Këshillit Kombëtar të Territorit nga ana e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit për konformitetin e kërkesës për pajisjen me Leje Ndërtimi

Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit pas shqyrtimit të konformitetit të kërkesës për pajisjen me Leje Ndërtimi, bën me dije Këshillin Kombëtar të Territorit.

Njoftimi bëhet në mbledhjen e radhës së KKT-së, ose me anë të njoftimit të anëtarëve dhe Kryetarit me shkresë zyrtare.

#### **Hapi V:**

Njoftimi i Autoritetit të Zhvillimit nga ana e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit për konformitetin e kërkesës për pajisjen me Leje Ndërtimi

Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit njofton Autoritetin e Zhvillimit, duke botuar në RIT njoftimin që i është bërë KKT në mbledhjen e radhës lidhur me konformitetin e kërkesave të paraqitura me rastet përjashtimore të pikës 2 të Vendimit të KKT-së nr.1, datë 30.07.2015.

#### **Hapi VI:**

Vendimmarrja e Autoritetit të Zhvillimit

Pas këtij momenti, Autoriteti i Zhvillimit ndjek procedurat dhe hapat e nevojshme për miratimin/ refuzimin e kërkesës për leje ndërtimi dhe pajisjen/ ose jo të aplikuesit me leje ndërtimi.

Autoritetet Vendore të Zhvillimit duhet të publikojnë në RIT, Vendimin e Lejes së Ndërtimit të shqyrtuar mbi bazën e njoftimit të AKPT, formularin e Lejes së Ndërtimit (shtojca C, VKM Nr. 408, datë 13.05.2015) dhe Planimetrinë e Lejes së Ndërtimit të miratuar.